

Njoftim për rinovim licence

Në mbledhjen e tij të datës 15.03.2023, Bordi i ERE-s vendosi:

- të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sha në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sha në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim nga data 16.03.2023 deri në datën 25.03.2023, pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë; ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.